



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI
KRYETARI

V E N D I M

Nr. 25 , datë 03.12.2021

PËR
FILLIMIN E PROCEDURAVE TË VLERËSIMIT, PIKËZIMIT DHE RENDITJES SË
KANDIDATËVE TË LEJUAR PËR VENDIN VAKANT NË GJYKATËN
KUSHTETUESE

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, të neneve 229, 239 dhe 240 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi,

V E N D O S I :

1. Fillimin e procedurave të vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve të lejuar për vendin vakant gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme për shkak të mbarimit para kohe të mandatit të gjyqtarit Fatmir Hoxha, e shpallur nga Gjykata e Lartë në datë 22.11.2018, 19.04.2019 dhe rishpallur në datën 03.06.2021.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

KRYETARI
DRVIN PUPE